

SHKUPI

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT


NUMËR PA
PAGESE

СКОПЈЕ

Numër 4 Viti II 2.04.2009

QYTETI I SHKUPIT PËR HERË TË PARË ME REJTING POZITIV KREDITOR
NË MËNYRË TEJET TË SHPEJTË PREJ KARPOSHIT DERI
NË AERODROM, ME BIÇIKLETË.

QYTETI I SHKUPIT - RAPORT (2005 – 2009)





"SHKUPI"

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
"Shkupi" u botua më
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Ljupčo Pandilovski

Zëvendës kryeredaktor
Nafie Selmani
Elena Kuzmanovska

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Fotografia
Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektorë
Behar Dalipi
Merita Abdullahi
Sadije Dalipi
Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni: REPRINT



Të nderuar shkupjan,

E rëndësishme është motoja: Siguro ditën e sotme, planifiko të ardhmen. Kjo është më shumë se një koncept. Kjo është më shumë se një moto, kjo është mënyra në të cilën funksionon qyteti i Shkupit katër vitet e kaluara. Nëpër këto faqe do të shikoni fakte për punën tonë në periudhën e kaluar. Transformimi ynë filloi me humbje dhe tani jemi në fazën e parë kur qyteti ka mjete që mund të ndahen për investime kapitale. Nëpërmjet një serie hapash strategjike arritëm të ripërcaktojmë funksionimin e qytetit. Është më se e qartë se pa një program me kualitet nuk ka zhvillim të qytetit. Por është akoma më e qartë se pa mjete adekuate nuk ka program me kualitet. Përcaktimi ynë është që çdo denar i dhënë nga qytetarët të shfrytëzohet në mënyrë adekuate.

Pas meje po lë projekte të cilat tregojnë se kisha një mandat të suksesshëm, me plot aktivitete, para se të gjithash për nevojat dhe interesat e qytetarëve të qytetit të Shkupit. Trashëguam një borxh prej administratës së mëparshme në vlerë prej 11 milion euro, i ngarkuar në mënyrë plotësuese edhe me disa milion euro nga kontestime gjyqësore të humbura. Trashëguam gjendje të keqe të ndërmarrjeve publike, të cilat ishin pothuajse në gjendje kolapsi, me borxhe, pajisje të amortizuara, drejtim jo efikas dhe resurse njerëzore modeste. Në sferën e kulturës gjetëm

institucione pa perspektivë të lëna pas dore pothuajse një dekadë të tërë. Problemet në qarkullimin publik dhe serviset komunale dukeshin pothuajse të pazgjidhshme. Punësimi sipas çelësit partiak dhe jo profesionalizmi i administratës përbënte një problem plotësues. Pritëm të përfundonin dy cikle të zgjedhjeve parlamentare, dhe që është akoma më e rëndësishme, në hije u lanë të gjitha proceset e decentralizimit. Marrëdhëniet partiak-politike vazhdimisht projektoheshin edhe në marrëdhëniet e pushtetit lokal dhe jo rrallë ishin pengesë për realizimin e qëllimeve të projektuara. Megjithatë, edhe përkrah këtyre kushteve objektive dua të vlerësoj se në katër vitet e kaluara kishim një bashkëpunim korrekt dhe produktiv ndërmjet Këshillit dhe Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Të nderuar bashkëqytetarë

Gjatë kohës së mandatit tonë përfunduan projekte kapitale siç janë pika lidhëse tek Kontinental, bulevardi Sllovenia, filluan projekte si rikonstrukcioni i Kopshtit zoologjik. Administrata e qytetit mori fizionominë e saj, institucionet kulturore filluan ta kthejnë primatin në qytet, me një fjalë vendosëm bazat për punë, filluam të rregullojmë punët.

Lëmë projekte të mëdha për kryetarin e ardhshëm, lëmë mjete për realizimin e investimeve kapitale, lëmë arkën e qytetit plot.

Është më se e qartë se Shkupi ka nevojë për një Ligj të ri të qytetit. Shkupit i duhen duar të lira që vetë të krijojë të ardhmen e tij. Shkupjanëve u duhet një kryeqytet-metropol i vërtetë. Duhet të gjenden zgjidhje për problemet e sotme, por që do të sjellin në një farë mënyre një parashikim për dekadat e ardhshme. Zgjidhje afatshkurtra, nuk janë zgjidhjet që na duhen.

Punuam për atë që e tashmja të jetë e mirë, kurse planifikojmë të ardhmen të jetë akoma më e mirë.

I juaji,
Trifun Kostovski

Sipas raportit të agjencisë së njohur në rang botëror Standart & Poor's

QYTETI I SHKUPIT PËR HERË TË PARË ME REJTING POZITIV KREDITOR



rejting BBB-për valutën lokale dhe BB+ për valutën e huaj dhe të dyja me formë negative. Vlerësimi për Qytetin e Shkupit është BB+ për valutën e huaj dhe BBB – për valutën vendase, me formë të qëndrueshme, që do të thotë se është një bazë e shkëlqyer për zhvillimin e mëtejshëm. Kritika për çdo punë gjithmonë ka dhe do të ketë, por jam më shumë se i lumtur që e lë qytetin ekonomikisht të qëndrueshëm me projekte të përfunduara dhe të filluara – theksoi kryetari Kostovski.

Ai shtoi se në raport thuhet se qyteti ka një borxh shumë të vogël dhe se ndjehet rritja e të ardhurave si rezultat i decentralizimit fiskal.

- Raporti i agjencisë Standart & Poor's jep vlerësim se qyteti ka pozicion të shkëlqyer likuidimi dhe se përmirësimet janë më se reale. Në të theksohet se edhe pse Qyteti i Shkupit në periudhën nga 2005-2008 ka fleksibilitet të vogël financiar dhe fuqi të vogël për mbledhjen e tatimeve arriti bilanc të fuqishëm operativ, me akumulimin e suficiteve të cilat sot sollën deri në një nivel të kënaqshëm mjeteve kesh të përcaktuara për investime kapitale. Anëtarë negativë që mund të tejkalohen me kalimin e kohës dhe për shkak të të cilave qyteti nuk mund të marrë rejting më të madh janë niveli fillestar i decentralizimit fiskal dhe barrës që mban Qyteti si obligime ndaj ndërmarrjeve publike. Jepet vërejtje se të ardhurat e Shkupit mbeten të limituara për shkak të kontrollit në të gjitha aspektet e financimit të vetëqeverisjes lokale nga ana e pushtetit qendror, ku është edhe kontrolli i bazës tatimore të të ardhurave të qytetit – shpjegoi kryetari.

- Në këtë drejtim edhe kërkesa jonë për hapjen e zyrës së Shkupit në Qytetin Bruksel, Shkupi mund të shfrytëzojë pjesë të këtyre fondeve. Edhe pse qeveria për këtë projekt tonin nuk dha dritë të gjelbër, më shumë se i kënaqur jam që pothuajse në të gjitha programet e kandidatëve për kryetarë të Shkupit, hapjen e zyrës e kanë prioritet. Ndoshta, pse jo dhe sigurt, që shumica e këtyre gjërave janë të njohura shumë mirë. E reja – marrja e rejtingut kreditor është një lajm i shkëlqyer për shkupjanët. Lëmë një qytet të qëndrueshëm kreditor, lëmë mundësi për zhvillimin e tij – theksoi kryetari Trifun Kostovski pas marrjes së rejtingut pozitiv kreditor.

- Sot kam kënaqësinë e veçantë t'ju informoj se Qyteti i Shkupit nga agjencia Standart & Poor's mori rejtingun e parë kreditor – BB i qëndrueshëm në nivel përmbledhës. Kjo do të thotë se është bërë hapi i parë me të cilin hapen mundësi për Qytetin për kreditimin e tij dhe realizimin e projekteve me rëndësi kapitale për Shkupin, siç është për shembull tramvaji. Se Qyteti i Shkupit si një nga debitorët më të mëdhenj në vend, katër vitet e kaluara me punë me nikoqirllëk u transformua në Qytet me saldo pozitive dhe me rejting kreditor të volitshëm. Rejtingu kreditor firmave dhe institucioneve shtetërore u siguron qasje më të lehtë deri te tregjet financiare botërore. Vetëm për krahasim, Maqedonia si shtet rejtingun e parë kreditor që e mori ishte BB plus për borxhin e brendshëm dhe BB për borxhin e jashtëm, ndërsa në këtë moment ka

Më 10 mars 2009, agjencia e njohur në rang botëror për rejting kreditor Standart & Poor's dha rejtingun e parë kreditor për Qytetin e Shkupit: BB i qëndrueshëm në nivel përmbledhës ose BB+ për valutë të huaj dhe BBB – për valutë vendase, me formë të qëndrueshme. Rejtingu kreditor pozitiv i Qyteti të Shkupit do të thotë se pas një kohe shumë të gjatë Qyteti i Shkupit nuk është më borxhli, se punojmë me saldo pozitive dhe hapet mundësi për aplikim para Fondeve evropiane për marrjen e mjeteve me të cilat do të realizohen investime kapitale me rëndësi të madhe për qytetin dhe për qytetarët e Shkupit, theksoi në konferencën për shtyp kryetari Trifun Kostovski.

Qyteti i Shkupit e përfundon projektin kapital për transport alternativ

Në mënyrë tejet të shpejtë prej komunës së Karposhit deri në komunën Aerodrom, me biçikletë.

Planet e Qytetit të Shkupit nuk përfundojnë me përfundimin e ndërtimit të korsisë së çiklistëve përgjatë anës së djathtë të bregut të lumit Vardar. Punët pritet që të vazhdojnë edhe përgjatë anës së majtë të bregut të lumit Vardar dhe me këtë do të mundësohet qarkullim i papenguar i biçikletave prej komunës së Karposhit deri në komunën Aerodrom.

Elena Kuzmanovska

Me biçikletë prej Karposhit deri në Aerodrom, pa pengesa dhe në mënyrë të sigurt përgjatë korsisë moderne dhe pa ndërprerje. Një mundësi e tillë do t'iu mundësohet qytetarëve të Shkupit me rrumbullakimin e projektit për ndërtimin dhe rekonstruimin e korsisë për çiklistët dhe rolerët në shtratin minor të lumit Vardar që tanimë për kohë prej një viti po realizohet nga ana e Qytetit të Shkupit. Përcaktimi i Qytetit të Shkupit për implementimin e transportit alternativ dhe të sigurt në qytetin tonë përdëftohet edhe me realizimin e këtij projekti tejet të madh dhe të dobishëm.

Qyteti i Shkupit këtë iniciativë të Kryetarit Kostovski planifikon që ta vazhdojë me ndërtimin e korsive për biçikleta dhe rolerë edhe përgjatë anës së majtë të lumit Vardar.

Edhe një herë i përdëftojmë orvatjet tona për ndërtimin dhe shënimin e korsive për biçikleta në qytetin e Shkupit, por gjithashtu edhe për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për

mundësitë për shfrytëzimin e biçikletave jo vetëm për rekreacion por edhe si një mjet alternativ të transportit. Me një sjellje të tillë të përgjegjshme ndaj ambientit jetësor në të cilin jetojmë të gjithë ne do të kontribuojmë për zvogëlimin e gazrave të dëmshme në ajrin dhe për shpenzim më ekonomik të resurseve energjetike. Korsinë e biçikletave e përfundojmë saktë në muajt kur kushtet klimatike dalëngadalë po stabilizohen dhe mund të lejojnë që biçikleta të shfrytëzohet si mjet alternativ i transportit – thotë Kryetari Kostovski.

Iniciativa për lidhjen e vendbanimeve Karposh dhe Aerodrom përmes një lidhjeje të pandërprerë për biçikletat filloi në fillim të vitit të kaluar. Ishin të përgatitura edhe projektet e nevojshme dhe njëherit u shpallën edhe tenderë për zgjedhjen e realizatorëve më të volitshëm të korsisë së biçikletave. Punët e konkretizuara ndërtimore filluan në muajin maj të vitit 2008 me ç'rast u ndërtua edhe pika e parë ndarëse përgjatë korsisë për rolerë dhe për biçikleta në shtratin minor të lumit Vardar, prej Qendrës transportuese deri te godina e PIOM. Kjo pikë ndarëse është e gjatë një kilometër kurse korsa ka një gjerësi prej katër metro. Korsa për vozitje është e asfaltuar kurse ambienti përreth është tërësisht i rregulluar.

Ndërtimi i korsisë për rolerë dhe biçikleta vazhdoi edhe pikëndarjen prej Qendrës transportuese deri te Ura e Gurit. Në këtë lokacion korsa ekzistonte por ajo ishte tërësisht e shkatërruar. Tani kjo pikë ndarëse e korsisë është e asfaltuar dhe në mënyrë përkatëse e shënuar. Këtyre ditëve është në rrjedhë e sipër furnizimi publik për ndriçimin e kësaj pjese – informojnë nga Sektori për planifikim dhe rregullim të hapësirës pranë Qytetit të Shkupit.

Këtyre ditëve, ekipet e "Pellagonija inzhenering" punojnë në pjesën e korsisë për biçikleta dhe rolerë prej godinës së PIOM deri te ura "Binak" në Aerodrom. Shtresa e korsisë është tërësisht e tamponuar gjithashtu janë të vendosur edhe bordurat.

Punëtorët presin që të stabilizohen kushtet klimatike që të fillojnë me asfaltimin të korsisë. Asfaltimi do të nënkuptojë edhe përfundimin e pike ndarëse prej korsisë për biçikleta.

Ideja e Kryetarit Kostovski është që Qyteti ta ndërtojë edhe pjesën e korsisë prej Urës së Gurit deri te ura e këmbësorëve prapa pallatit të Qeverisë.

Po përgatitemi që ta rregullojmë edhe këtë pjesë të korsisë. Pasi që tërësisht do t'i ndërlihim vendbanimet Karposh dhe Aerodrom përmes korsisë së biçiklistëve përgjatë anës së djathtë të lumit Vardar do të vazhdojmë të punojmë edhe përgjatë anës së majtë të lumit. Në këtë drejtim, punët do të fillonin së pari prej pjesës qendrore të qytetit, në pjesën në mes Urës së re dhe godinës së MANU. Korsa për rolerë dhe biçikleta përgjatë anës së majtë të lumit Vardar gjithashtu do të mundësojë lidhjen e vendbanimeve Karposh dhe Aerodrom. Për ndërtimin e plotë të korsisë përgjatë anës së djathtë të bregut, Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 20 milion denarë, mjete që janë të parapara në buxhetin ekzistues – thonë prej Sektorit për planifikim dhe rregullim të hapësirës pranë Qytetit të Shkupit.





Shirita të kuq nëpër rrugët e qytetit

Qyteti i Shkupit në mënyrë aktive u inkuadrua në projektin për shënimin e shiritave të kuq nëpër rrugët e qytetit, përgjatë të cilave lejohet qarkullimi vetëm i biçikletave. Ky projekt i organizatës joqeveritare “Proaktiva” dhe Ambasadës së mbretësisë Holandeze në shtetin tonë u përkrah pa rezervë nga ana e Qytetit të Shkupit.

- Projekti përfshiu shënimin me ngjyrë të kuqe të shiritave të komunikacionit përgjatë rrugëve të qytetit dhe nëpër udhëkryqet që do të rezervohen vetëm

për qarkullimin e biçikletave. Qyteti e përpiloi revizionin për nga aspekti i trafikut, gjithashtu bëri intervenime për lëshimin e bordurave në pjesët në të cilat kjo ishte masë e domosdoshme, i ngjyrosi korsitë dhe vendosi sinjalizimin horizontal dhe vertikal të trafikut. Punët u zhvilluan prej Aerodrom deri te ura “Kombet e bashkuara” nëpër udhëkryqet dhe akset kryesore të trafikut – thonë prej Sektorit për planifikim dhe rregullim të hapësirës pranë Qytetit të Shkupit.

Korsia moderne e këmbësorëve në Gjorçe Petrov

Si pjesë e projektit për rregullimin e korsive në qytetin e Shkupit, Qyteti i Shkupit para dy muajve ndërtoi korsi për këmbësorë prej urës në Saraj në drejtim të fushës sportive për futboll, përgjatë lumit Vardar.

- Kjo korsia është e gjatë 1.100 metro dhe e njëjta është e mbuluar me behaton pllaka me një sipërfaqe prej rreth 3.000 metro katrorë. Ndërtimi i saj kushtoi pesë milion denarë. Ndërtimi i kësaj korsie është investim i Qytetit

të Shkupit, planet e të cilit nuk përfundojnë këtu. Këtyre ditëve është në rrjedhë thirrja publike për realizues të punëve ndërtimore për edhe një kilometër prej korsisë përgjatë lumit. Për këtë pikë ndarëse do të nevojiten edhe katër milion denarë që tanimë janë të parapara në buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2009 – thonë prej Sektorit për planifikim dhe rregullim të hapësirës pranë Qytetit të Shkupit.





Buxhetet e metropoleve në Evropën juglindore

Beogradi do të shpenzojë 757 milion euro

Buxheti i qytetit Beograd për vitin 2009 do të jetë 757 milion euro. Të ardhurat e planifikuara janë 658 milion euro, kurse shpenzimet 653 milion euro, me suficit buxhetor prej 5 milion euro. Në raport me shpenzimet, më së shumti mjete financiare – 250 milion euro ose rreth 38 përqind i buxhetit do të shpenzohet për ndërtimin e objekteve infrastrukturore edhe atë: 144 milion euro për objekte ndërtimore dhe objekte të infrastrukturës komunale të cilat financohen përmes Drejtorisë për truall ndërtimor dhe ndërtim në Beograd, më pas 45 milion e 588 mijë euro për rrugë dhe kalimet hekurudhore, si dhe 10 milion dhe 600 mijë euro për Agjencinë për investime që do të investojë në rikonstruksionin e infrastrukturës së komunikacionit dhe ndërtimit të objekteve.

Për arsim janë parashikuar mjete në vlerë prej rreth 8 milion e 700 mijë euro të cilat do të destinohen për ndërtimin e disa shkollave të reja fillore, si dhe renovim të një numri të shkollave tjera.

Për punë komunale dhe banesore janë parashikuar rreth 3 milion euro, të destinuara për realizimin e projekteve për ngrohje dhe ujësjellës si dhe për objekte të ndriçimit publik dhe dekorativ. Subvencionet për ndërmarrjet publike, organizatat dhe kompanitë private në vitin 2009 do të jenë rreth 83 milion e 500 mijë euro që do të thotë rreth 12,7 përqind e Buxhetit.

Ky zvogëlim i dukshëm në krahasim me vitin e kaluar është rezultat i përcaktimit të fuqishëm të qytetit të Beogradit që përmes zvogëlimit të subvencioneve të lirojë pjesë të mjeteve të destinuara për projekte investuese kapitale përmes krijimit të kushteve që ndërmarrjet publike shpenzimet për punë t'i financojnë nga të ardhurat e realizuara nga çmimet e shërbimeve.

Irena Misheva,
Kryetare e Këshillit të Qytetit të Shkupit

ÇDO GJË NGA QYTETARI DHE ÇDO GJË PËR QYTETARIN E SHKUPIT

Si kryetare e Këshillit të Qytetit të Shkupit, në fillim dua ta shpreh kënaqësinë time të shkallës së lartë të mirëkuptimit dhe korrektësisë mes këshilltarëve në katër vitet e kaluara, pavarësisht përkatësinë e tyre politike, në punën dhe konstituimin e pozitës së re të Qytetit të Shkupit.

Në periudhën që lamë pas kishim shumë obligime, shumë probleme, ishim të ballafaquar me shumë sfida të cilat vinin para nesh si këshilltarë dhe mund të them sfida me të cilat përballeshim si gjeneratë e parë e këshilltarëve që punonim në përputhje me procedurat dhe aktet ligjore në procesin e fillimit të decentralizimit.

Marrja e kompetencave të reja, organizimi i administratës së qytetit, konsolidimi i gjendjes financiare të qytetit, por edhe i ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike, paraqisnin sfida të cilave duhej tu përgjigjet Këshillit i Qytetit të Shkupit.

Konsideroj se pikërisht duke falënderuar mirëkuptimin e ndërsjellë, konsistencën dhe parasëgjithash përkushtimin moral dhe etik të këshilltarëve nga njëra anë dhe bashkëpunimin me kryetarin e qytetit dhe administratën e qytetit nga ana tjetër, në tërësi arritëm t'i realizojmë të gjitha sfidat të cilat na u paraqitën në fillimin e mandatit.

Decentralizimi, planet për punë, programet e ndërmarrjeve publike, investimet e mëdha kapitale, subvencionet e ndërmarrjeve publike, politika e re kulturore, studimet fizibilitet për gazifikim dhe transport hekurudhor, si dhe strategjitë e shumta të miratuara në këtë periudhë janë pjesë e akteve të miratuara në 84 seancat e Këshillit. Për të realizuar me sukses të gjitha projektet e numëruara këshilltarët përgatitjet i bënë në 22 komisione dhe trupa ndihmëse të Këshillit. Për këtë shkak, në veçanti theksoi konsensusin, si përfitim dominant, meqë nga 17 partitë politike të përfaqësuara në të çdo herë arrinin të ngrihen mbi interesin politik, kur bëhej fjalë për çështje me interes të veçantë për



qytetarët në rendin e ditës. Por jo vetëm për temat e përmendura, e njëjtë ishte marrëdhënia edhe për arsim, mbrojtje sociale menaxhim me të gjitha segmentet e asaj që paraqet Qyteti i Shkupit, si dhe kujdesi për Brigadën kundër zjarreve.

Në fund të mandatit, mund të konstatoj se arritëm edhe përfitim të madh në komunikimin me qytetarët dhe transparencë në punë dhe vendim-marrjet e këshillit; si në planin e komunikimit të drejtpërdrejt me ta, ashtu edhe me bashkëpunimin përmes organizatat joqeveritare.

Qytetin e Shkupit e ndjenim si qytetin tonë, qytet të cilin donim që të zhvillohet, gjatë së cilës kemi kultivuar dimensionin e tij kozmopolit, qytet në të cilin kultivua historinë e tij, traditën, kujdeseshim për përfitimet nga e kaluara, por në të njëjtën kohë e zhvilluam të tashmen dhe si Këshill kishim vizion të fuqishme për të ardhmen.

Jemi krenar që këshilltarëve që do të na zëvendësojnë në stolet këshilltare, ju lajmë për herë të parë ambient të ri të punës, sallë të re të cilën do ta ndiejnë menjëherë sa po të hynë në të, pasi që ka histori, me pamje të re ashtu siç përgjigjet me dinjitetin e qytetarëve, ju lamë edhe aktet bazë, siç janë Statuti dhe Rregullorja për punë e Këshillit të qytetit të Shkupit si instrumente bazë për punë, me çka menjëherë do të mund të fillojnë me punë.

Krahas kësaj, mbeten mjete dhe buxhet i ndarë zhvillimor, me të cilin në mënyrë më efikase në të ardhmen do të mund t'i planifikojnë dhe realizojnë projektet e tyre.

Ju lamë edhe E – këshillin, mekanizëm i cili në mënyrë plotësuese do ta rritë transparencën dhe efikasitetin e këshilltarëve të rinj dhe kjo është edhe një nga arritjet e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Në fund e lamë edhe moton tonë “ÇDO GJË NGA QYTETARI DHE ÇDO GJË PËR QYTETARIN E SHKUPIT”, si ide e vetme e secilit që do ta ketë nderin të jetë këshilltar i Këshillit të Qytetit të Shkupit.

QYTETI I SHKUPIT RAPORT 2005 – 2009

Qyteti i Shkupit është qytet me shpirt të gjerë. Qytetet e mëdha janë ndërtuar nga persona të përkushtuar. Shkupi meriton të gjallërohet si metropol i vërtetë, si qendër e vërtetë kulturore dhe ekonomike e Maqedonisë. Ja se çfarë bëri Qyteti i Shkupit në këtë drejtim në katër vitet e kaluara në mandatin e kryetarit të Qytetit Trifun Kostovski.

URBANIZËM

Pikëlidhësja tek “Kontinentali”



Në kohën e mandatit të kryetarit Trifun Kostovski ndodhi projekti grandioz i cili ndërtohej 14 muaj – pikëlidhësja tek hoteli “Kontinental”, e lëshuar në përdorim në mënyrë solemne më 13 Nëntor 2008. Pikëlidhësja është udhëkryq i madh në dy nivele, në të cilin komunikacioni zhvillohet pa semaforë dhe pa ndërprerje. Me të u zgjodh ndërprerja kronike në komunikacion tek Bit Pazari dhe tek Pallati gjyqësor. Në të njëjtën kohë është mundësuar lidhje direkt nga lagjja Autokomandë drejt Stacionit hekurudhor. Me rrugën e mesme dhe unazën, për herë të parë u mundësua kthim komunikacioni mbrapa drejt Çairit dhe bulevardit Nikolla Karev.

Në unazën ka barriera të zëshme. Pikëlidhësja është e pasuruar edhe me zhardineri betoni.

Në këtë projekt Qyteti i Shkupit investoi tre milion euro.

Zhardineri të reja në bulevardet e Shkupit

Qyteti i Shkupit në buxhetin për vitin 2009 ndau 30 milion denarë për ndërtimin e zhardinerive të reja në brezat e mesme të bulevardëve të Shkupit.



Zhardineria në Kuzman Josifovski – Pitu është me gjatësi prej 920 metra dhe do të shtrihet nga Stacioni hekurudhor deri në Bankën popullore të Maqedonisë, kurse ajo në Jane Sandanski do të jetë me gjatësi prej 800 metra. Zhardineria në bulevardin Partizanski odredi është e gjatë 2.650 metra dhe është në pjesën nga Ruzveltova deri në urën “Kombet e Bashkuara”. Bulevardin 8 Shtatori do ta zbukurojë zhardineri e gjatë 1.100 metra e cila do të ndërtohet nga fabrika “Alumina” deri në rrugën Ilindenska.

Pas përfundimit të punëve ndërtimore “Parqe dhe gjelbërim” do të instalojnë sistem për ujitje “pikë pas pike” dhe në zhardineritë do të mbillen lule dhe kaçube të ulëta.

Bulevardi Sllovenia

Bulevardi Sllovenia, i gjatë 1,8 kilometra, është bulevardi i vetëm i ri i cili është ndërtuar në Shkup në dy decaet e fundit. U ndërtua një vit dhe paraqet lidhje komunikacioni të komunës Karposh me Çair dhe Butel. Është i rëndësishëm edhe për zhvillimin e zonës industriale Vizbeg, si dhe për promovimin e Akueduktit, i cili gjendet në afërsinë e tij dhe i cili paraqet monument të kulturës.

Gjatësia e bulevardit, në bashku me krahët, është 2.400 metra. Ka katër korsi nga të cilat secila është e gjatë 3,5 metra. Është ndërtuar sipas të gjitha standardeve për bulevarde dhe paraqet një nga projektet më të kushtueshme të Qytetit. Investimi ka kushtuar katër milion euro.

Zgjerim i Ilindenskës

Zgjerimi i bulevardit Ilinden, nga shatërvani “Lulja e lotosit” deri në udhëkryqin me bulevardin 8 Shtatori, është punë të cilën duhet ta përfundojë pushteti i ri i qytetit. Edhe pse qyteti posedonte dokumentacion të plotë, komunat për shkaqe të paqarta, një vit kundërshtuan që të japin leje ndërtimi për këtë punë.

Për zgjerimin e Ilindenskës, si një nga premtimet e kryetarit Trifun Kostovski, janë siguruar mjete, realizues, dhe

janë ndërtuar 500 metra të kanalizimit atmosferik në pjesën e Ilindenskës ku nuk ekzistojnë probleme pronësore – juridike.

Shtëpia e pionierëve Karposh me pamje krejtësisht të re

Ndërtesa e vjetër e Shtëpisë të pionierëve Karposh në bulevardin Ilinden do të kthehet në jetë. Pas katër decaiesh lënie pas dore, Qyteti i Shkupit filloi me rikonstrukcion të plotë të kësaj shtëpie të kulturës. Qyteti i Shkupit për freskimin e monumentit të kulturës ndau gjashtë milion denarë.

Zgjerim i udhëkryqeve tek “Kombinati i duhanit”

Qyteti i Shkupit muajin e kaluar filloi me zgjerimin e udhëkryqeve dhe rrugëve tek “Kombinati i duhanit”. Pas përfundimit të punëve ndërtimore do të sigurohet lëvizje me e lehtë e automjeteve në këtë pjesë të qytetit, ku me vite, për shkak të grykës së ngushtë, mbizotëron qarkullim i padurueshëm e komunikacionit.

- Korsi e re në bulevardin Vidoe Smilevski – Bato



- Rikonstrukcion i parterit hyrës në Çarshinë e vjetër

- Bulevardi Goce Dellçev me dy korsi të reja automobilistike

- Depërtim e bulevardit Serbia tek fabrika e çimentos “Usje”

- Ndërtim i rrugës servisuere për ndërtesën sociale në Butel

- Kaosi tek Spitali i qytetit është zgjidhur me zgjerimin e rrugës

- Urë në lumin Vardar tek Qendra transportuese

- Depërtim në Teodosij Golloganov dhe Adolf Ciborovski drejt Gjorçe Petrovit

- Rikonstruksion i rrugës Elisie Popovski – Marko në Qendër

- Ripërtëritje e rrugës Butellska

- Rregullim i trotuareve në rrugët Vostanička dhe Përzino në Kisella Vodë

- Sanim i rrugëve në Qendër, Karposh dhe Radishan

- Depërtim në bulevardin Makedonska vojska



- Asfaltim i rrugëve në Karposh dhe mbulim i gropave në Butel

- Asfaltim i rrugës Lisec në Lisiçen e Sipërme

- Asfaltim i rrugëve në Autokomandë dhe Çento

- Ndërtim i 21 rampave hyrëse në shkollat e mesme dhe në institucionet kulturore



- Ndërtimi i nyjes “Thërfli”

- Rikonstruksion i trotuareve në Rrugën e “plastikave” në Çair

- Sanim i gropave kryesore në Kisella Vodë, Gjorçe Petrov dhe Qendër

- Asfaltim i rrugës 37 në Singeliq

- Sheshi para kishës “Shën Mëria”

- Asfaltim i rrugës drejt fakultetit Matematiko – natyror

- Janë rregulluar rrugë në Kisella Vodë, Karposh, Qendër dhe Gjorçe Petrov

VEPRIMTARI KOMUNALE

Gazifikim

Për të filluar gazifikimi në qytet, në vitin 2007, me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit, u formua ndërmarrja publike “Energjetika Shkup”. Kompetencat e ndërmarrjes publike janë distribuimi i gazit natyror, menaxhimi me sistemin e distribuimit të gazit, furnizim me energji ngrohëse, distribuimi i energjisë gjeotermale, si dhe prodhimi i energjisë nga burimet energjetike të ripërtëritshme.

Me qëllim gjetjen e partnerit strategjik i cili do të kishte investuar në rrjetin e gazit dhe të cilit do t’i shiten gjysmat e aksioneve, ndërmarrja më pas u transformua në shoqëri aksionare. Studimin për vlerësimin e gazifikimit të Shkupit e përpiloi firma turke “Igdash”. Sipas saj ndërtimi i rrjetit primar do të kushtonte rreth 45 milion euro, kurse gazifikimi i plotë i qytetit do të kushtonte rreth 100 milion euro. Gazifikimi i plotë i qytetit do të ndodhte në vitin 2026.

Ndërtim i rrjetit fekal dhe atmosferik në Maxhari dhe Inxhikovë

Ndërmarrja publike “Ujësjellës dhe kanalizim” para pesë vitesh filloi me ndërtimin e kanalizimit fekal në vendbanimet Maxhari, Hipodrom, Inxhikovë dhe Stajkovci, por ndërtimi intensiv zhvillohej në mandatin e kryetarit të Qytetit Trifun Kostovski. Ka të bëjë me projektin më të madh të ndërtimit të rrjetit fekal në të gjithë Maqedoninë, e gjatë 14 kilometra. Instaloheshin gypa të gjerë një metër, kurse punohej në thellësi prej 7,2 metra. Në procedurë është faza e dytë e gjithsej katër fazave, me qëllim që kanalizimi të lëshohet në përdorim. Përveç mungesës së të hollave, problem gjatë ndërtimit kanë shkaktuar edhe ujërat nëntokësor.

Shuma e përgjithshme për këtë investim është 120 milion denarë, prej të cilave 61 milion siguroi Qeveria, me iniciativë të komunës Gazi Babë.



- Projekt kanalizim fekal për Butelin dhe Radishanin

- Projekt për zëvendësimin e gypave të ujësjellësit nga azbesti në qytet

- Rrjet i ri i ujësjellësit për zonën e lartë të rrugës Lovqenska

- Riparimi i rrjetit të dëmtuar të hidrantëve

- Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Dizhonska në Çair

- Mbulimi i kanalit në Shuto Orizare dhe ndërtimi i kanalizimit të ri atmosferik

- Kanalizimi atmosferik në rrugën Përvomajska në Kisella Voda

- Kanalizimi atmosferik në rrugën Pelincë

- Kanalizimi atmosferik në Usje - Përzhinë

- Sistemi i kolektorit në Shuto Orizare dhe kanalizimi atmosferik në Çair

- Kanalizimi atmosferik dhe kolektori fekal në rrugën Llazar Liçenovski në Qendër

MBROJTJA E AMBIENTIT JETËSOR

B – lejet ekologjike të integruara

Kryetari Trifun Kostovski në muajin shkurt të vitit 2009 ndau lejen e parë B-të integruar për funksionim ekologjik firmës “IGM Vratnica”, filiali në Vizbeg. Për fitimin e lejes B të integruar kanë aplikuar edhe 28 firma në territorin e qytetit të Shkupit.

Firmat që do të marrin lejen e lartpërmendur do të dëshmojnë faktin se ata prodhojnë pa e ndotur ambientin jetësor, duke i respektuar të gjitha standardet ekologjike që vlejné në shtetin tonë. Dhënia e lejeve B të integruara ekologjike do të realizohet nga ana e Sektorit për ambientin jetësorë pranë Qytetit të Shkupit dhe një gjë e tillë është e përcaktuar me urdhëresë nga ana e qeverisë dhe në të janë të parapara aktivitetet, plani operativ si dhe orari për dorëzimin e kërkesave për të fituar këtë leje.

Selektimi i mbeturinave në Taftalixhe

Në muajin nëntor të vitit 2007, Ndërmarrja publike “Higjiena komunale” filloi me realizimin e pilot – projektit për selektimin e mbeturinave në vendin tonë. Faza e parë e pilot projektit parashikon që qytetarët që jetojnë në Taftalixhe, komuna e Karpshit, t’i ndajnë shishet plastike, kanaçet si dhe letrën e skaduar prej mbeturinave të tjera të amvisërive dhe të njëjtat t’i deponojnë në qese me ngjyrë të verdhë, të kuqe dhe të kaltërt. Kështu këto mbeturina të selektuara, ekipet e ndërmarrjes komunale do t’i grumbullojnë një herë në javë.

Selektimi i mbeturinave do të zbatohet në nivel të tërë qytetit, por pasi të shqyrtohen të gjitha dimensionet e realizimit të tij në Taftalixhe.

Pilot – projekti u realizua në bashkëpunim me komunën e Karpshit dhe me USAID.

Modernizimi i deponisë Drislla

Qyteti i Shkupit, në mandatin e kryetarit Kostovski realizoi negociata me

disa firma për realizimin e projekteve në deponinë Drislla për modernizimin e sajë si dhe për zvogëlimin e ndotjeve të ambientit jetësor. Tema e negociatave u shfrytëzua në drejtim të shfrytëzimit të kapaciteteve të deponisë, përkatësisht shfrytëzimin e metanit për prodhimin e energjisë elektrike.

- Aksioni “Kurseje natyrën” për pastrimin e Vodnos dhe të kejit

- Mirëmbajtja e shtratit minor – të poshtëm të lumit Vardar



- “Higjiena komunale” e mori përgjegjësinë për higjienën në Vodno dhe Matkë Çisterna dhe panorama të vendosura në Vodno

- Pusi dekorativ dhe panorama në Parkun e qytetit

- Është rregulluar pejsazhi karakteristik - „Gazi Baba”

- Është ndërtuar klasa verore në Vodno

- Janë të mbjellura 2.000 fidanë në Vodno

- Aksioni i madh për pastrimin e parkut dhe të kejit

- Janë mbjellur 590 fidanë të reja në rrugët dhe bulevardet e qytetit

- Aksione të rregullta për pastrimin e gjelbërimit prej gjetheve dhe mbeturinave

- Njëqind fidanë të reja prej „Alumina” deri te konvikti i studentëve “Goce Dellçev”

- Aksioni - “E shtunja e gjelbër” për

pastrimin e parkut të qytetit

- Janë të mbjellura 955 fidanë në Karposh dhe Gjorçe Petrov



KOMUNIKACIONI

Pagesa elektronike në transportin publik dhe përcjellja automatike

NQP “Shkup” prej këtij viti do të filloj me pagesën në transportin publik të quajtur si sisteme “smart ticketing”. Firma turke “Kësmet kart” do të instaloj pajisje elektronike në 250 autobusë.

Kartelat e reja do të mundësojnë pagesë pa para të gatshme për shërbimin e ofruar. Të njëjtat do të skadojnë për pesë vite, përkatësisht do të blihen një herë dhe më pas vetëm do të plotësohen.

Paralelisht me implementimin e pagesës elektronike, NQP do ta realizoj edhe projektin për përcjellje elektronike të autobusëve. Me këtë sistem do të përcillet se sa autobusët do t’i përmbahen orarit të vozitjeve, por njëkohësisht do të përcillet edhe shpenzimi i lëndëve djegëse.

- Numëruesit e dritave të gjelbërta dhe të kuqe në semaforët e qytetit të Shkupit



- Janë montuar 1.000 lanterna kursyese në semaforët

- Gazifikimi i 42 autobusëve të NQP

- Stacioni i ri për autobusët ndërrurban

- Sinjalizimi i zëshëm në semaforët për personat e verbët

- Vala e gjelbër në udhëkryqet vitale të qytetit të Shkupit

- Korsi e re e biçikletave në Aerodrom

- Shënimi i rrugëve dhe zëvendësimi i shenjave të komunikacionit

- Semaforë të rinj në "Përvomajska"

KULTURA

Hepeningu kulturorë – "Nata e bardhë"

Sipas shembullit të qendrave të mëdha kulturore siç janë Roma, Parisi, Brukseli, për herë të parë në vitin 2005, Qyteti i Shkupit e organizoi manifestimin "Nata e bardhë". Kjo është një ngjarje me ç'rast për një natë angazhohet i tërë potencialin krijues dhe kreativiteti ekzistues në qytet kurse qytetarët janë ftuar për të realizuar një takim të drejtpërdrejtë me kulturën, sportin, artin, solidaritetin, kualitetet e jetës. Gjatë mbajtjes së këtij manifestimi i cili zgjat prej orëve të mbrëmjes deri në orët e mëngjesit, qyteti i Shkupit shëndërohet në një qendër të ndodhive të shumta siç janë teatri, solidariteti, vallëzimet, sporti, muzika, shoppingu.



U jepet jetë vendeve të rëndësishme të qytetit duke filluar prej atyre që janë më tradicionale deri te hapësirat më alternative për shprehje shpirtërore.

Qyteti i Shkupit, në periudhën prej vitit 2005 deri në vitin 2008, shumë për përkrahje të këtij manifestimi kulturorë e zmadhoi për shtatë herë, përkatësisht prej shumës prej 4.5 milionë denarë e zmadhoi në 31.6 milionë denarë.

Baskerfest

Shkupjanët, për herë të parë në vitin 2006, nën sponzorimin e Qytetit të Shkupit, patën rastin që të bëhen pjesë e festivalit internacional multikulturor "Baskerfest", i cili ofroi performansa të pa para deri më tani në kryeqytetin tonë.



Festivali i cili zgjat disa ditë, ofroi mundësin për shoqërimi të qytetarëve me zhonglerët, akrobatët, mahitarëve, gëlltitesit e zjarrit edhe me shumë argëtues të tjerë, të pa parë deri më tani, aktorë të rrugës. Argëtimi për qytetarët tani për tre vite është falas.

"Vallja gjithë Evropiane e maturantëve" për herë të parë në Shkup

Vallëzimi masovik i maturantëve nga të gjitha shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, në sheshin "Makedonija", për herë të parë u realizua në vitin 2007. Parada e maturës e vallëzimit më të madhe të sinkronizuar në botë, u organizua nga Qyteti i Shkupit, Sektori për bashkëpunim ndërkombëtarë si de Seksioni për arsim pranë Sektorit për veprimtari publike të Qytetit të Shkupit. Kjo paradë, në të cilën maturantët e qytetit të Shkupit morën pjesë në shkëlqen e Rekordit të Guinesit, përmes satelitit e përcollën mbi 150.000 shi-

kues. Sheshi i qytetit të Shkupit ishte njëri prej 50-të lokaliteteve në Evropë ku u mbajt ky manifestim.

Manifestimi "Tingujt e Çarshisë"

Me qëllim që vizitorëve tu tërhiqet vëmendja ndaj monumentit kulturorë dhe shpirtërorë – Çarshisë së vjetër, Qyteti i Shkupit së bashku me Komunën e Çairit, e promovoi manifestimin "Tingujt e Çarshisë". Vëmendja e vizitorëve u përqendrua falë koncerteve atraktive, ekspozitave, programeve për fëmijë dhe programeve filmike, shfaqjeve për fëmijët, zhonglerëve, boulistëve. Në suaza të manifestimit "Tingujt e Çarshisë", në Odën e zejtarëve u debatura edhe për problemet e esnafit si dhe ringjalljes së zejeve të vjetra siç janë arti i filigranit, opingarisë, poçarisë, jorganxhisë, kazanxhisë dhe lëkurëtarisë.

- U formua Orkestra i Qytetit

- U hap Teatri i Qytetit - „Shkupi“

- U përkrah brendi më i madh në Republikën e Maqedonisë - „Xhaz Festivali i Shkupit“

- U përkrah – Vera e Shkupit, „Sinedej“,

- Teatri i hapur për të rinjtë...

- Projekti - "Shkupi Metropol"

MATKA

Manifestimi - "E dua Matkën"

Qyteti i Shkupit dhe organizata joqeveritare "Fagrikom" organizuan shoqërimin e madh me qytetarë për promovimin e projektit për mbrojtjen e biodiversitetit në monumentin e natyrës. Manifestimi u zhvillua nën moton - "E dua Matkën".

Aktivistet e shoqatës ekologjike - "Eko – aksioni" nga Saraji mbollën 40 fidanë, si donacion i shoqatës dhe në këtë mënyrë e përkrahën projektin e Qytetit të Shkupit.



Qyteti siguroi transport dhe ushqim falas, kurse vizitorët i argëtuan etnobotanikët "Bakllava" dhe "Lubojna". Fëmijët patën rastin që të kënaqen në shfaqjen e palaçove.

Revitalizimi dhe renovimi i Matkës

Qyteti i Shkupit në suaza të projektit për revitalizim dhe renovim të monumentit të natyrës në qytetin e Shkupit – kanjonin Matka, realizoi një sërë aktivitetesh të cilat tërësisht e ndërruan pamjen e këtij vendi.

Hapësira ekzistuese për parkim u zgjerua, gjithashtu u vendosën edhe tetë kandelabra të reja. Për këtë qëllim u zëvendësua i tërë instalimi elektrik. Në shtëpinë alpiniste u instaluan pesë fanarë me pamje autentike si dhe një reflektorë i madh. Ai është i drejtuar kah shkëmbinjtë me qëllim që t'i ndriçoj deri në orët e vona të mbrëmjes.

Përreth kishës "Shën Andrea" u vendos një rrethojë mbrojtëse në gjatësi prej shtatëdhjetë metro, me këtë Qyteti i Shkupit e zmadhoi sigurinë e të gjithë vizitorëve.



Para shtëpisë së alpinistëve si dhe para kishës "Shën Andrea" tërësisht u mënjanua pajisja e vjetër e parkut, përkatësisht u vendosën njëzet tryeza të reja të drurit në formë të trekëndëshit.

Korsia për këmbësorët, në gjatësi prej 3.5 kilometra gjithashtu u rinovua. Edhe atë prej "Pykës" deri te ura që gjithashtu paraqet një risi në kanjonin e Matkës.. Qyteti i Shkupit ndau 10 milion denarë për realizimin e urës pezulluese përmes të cilit do të mundet në këmbë të arrihet deri te tre shpellat, Vrello, Kërshtella dhe Ubava.

KOPSHTI ZOOLOGJIK

NJË KOPSHT I RI DHE MODERN ZOOLOGJIK DO TË MBIJË NË ZËMËR TË QYTETIT TË SHKUPIT

Kopshti zoologjik i Shkupit për dy vite do të fitojë një pamje evropi-

ane. Atëherë pritet që të përfundojë tërësisht rekonstrukcioni i cili filloi në vitin 2006.



Me dekada në të kaluarën, ky kopsht për qytetarët ishte vetëm një vend ku kafshët kultivoheshin në kushte joadekuate ose ishin të maltretuar nga ana e qytetarëve të pandërgjegjshëm.

Rekonstrukcioni i këtij objekti kapital u realizua me mjetet e Qytetit të Shkupit, të Qeverisë si dhe me mjetet e personave juridik dhe fizik.

Për tre vite u shpenzuan 2,5 milionë euro kurse i tërë projekti kushton 4 milion euro. Projekti i cili ishte i financuar nga ana e qytetit të Nyrnbergut, u përpilua nga ana e Martin Shuker, arkitektit amerikan i cili është i specializuar për përpilimin e projekteve për Kopshtet zoologjike si dhe Dag Enke, drejtor i kopshtit zoologjik të Nyrnbergut.

Për tre vite tërësisht është zëvendësuar infrastruktura kurse kafshët fituan tre habitate të reja që janë të adaptuar sikur mjediset prej ku vijnë ato. Gjithashtu u pasuruan edhe me shkëmbinj dhe drunj dhe janë të rrethuar me balvane të drunj.



Në kopshtin zoologjik të rekonstruktuar, si donacione prej kopshteve të tjera zoologjike do të arrijnë edhe shumë kafshë të reja kurse për të punësuarit janë parapara edhe trajnime plotësuese edukative.

Udhëheqësia e kopshtit zoologjik dorëzoi edhe kandidaturën për anëtarësi në Lidhjen Evropiane të kopshteve zoologjike dhe akuariumeve (LEKZA). Në muajin maj të këtij viti pritet që të arrijë komisioni i cili do të jap vlerësimet për atë se vallë kopshti i plotëson kushtet për tu anëtarësuar në të këtë lidhje.

U ndërtuan dy byrotë e para turistike

Me qëllim të zhvillimit më efikas të turizmit në qytetin e Shkupit si dhe për promovimin e kulturës së qytetit, në ambientet e Qendrës kulturore informative, si dhe në suaza të Qendrës transportuese, Qyteti i Shkupit hapi dy zyre turistike.

Detyra e të punësuarve në këto objekte është që të ndërmjetësojë në sigurimin e shërbimeve në fushën e akomodimit të turistëve si dhe për shitjen e biletave për manifestimet kulturore, argëtuese dhe rekreativo-sportive dhe ekonomike.

Modernizimi i brigadës së zjarrfikësve të qytetit të Shkupit



Kryetari i Qytetit të Shkupit z. Trifun Kostovski këtë vit ndau 300 pajisje mbrojtëse dimërore për të punësuarit në Brigadën e zjarrfikësve të qytetit të Shkupit. Qyteti i Shkupit, qëndrimin e saj ndaj këtyre njerëzve të guximshëm, në mandatin e kryetarit Kostovski, e shprehu me aksione të vazhdueshme për ndarjen e pajisjeve por edhe me shumë donacione nga qytetet e vëllezëruara që kontribuan për modernizimin e brigadës. Vlera e ndarjes së pajisjeve mbrojtëse dimërore ishte në vlerë prej 1. 840.000 denarë.

Duke e vlerësuar kualitetin e punës që ushtrojnë zjarrfikësit por edhe profesionalizimin e tyre, Qyteti këtë vit ndau 25.880.000 denarë për furnizimin e automjeteve zjarrfikëse, veturë tereni si dhe pajisje të tjera informatike dhe të komunikacionit.

**U PRISH TENDERI PËR
TRAMVAJIN E SHKUPIT**

Projekti i përgatitur gjatë dhe me rëndësi vitale për qytetarët e Shkupit, transporti alternativ i tramvajit, dësh-toi, për shkak se në thirrjen e shpallur publike nga ana e Qytetit të Shkupit asnjë firmë nuk konkuroi me ofertë. Në fazën e përgatitjes së furnizimit publik 17 korporata me renome evropiane të kësaj fushe tërhoqën dokumentacion për pjesëmarrje në furnizimin publik. Të gjitha kompanitë ishin të Unionit Evropian dhe mes tyre edhe korporata nga Austria, Çekia, Spanja, Franca, Italia, Gjermania, korporata të cilat me decenie kanë punuar në ndërtimin e sistemit me shina dhe automjete për gati të gjitha metropolet botërore.

Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski, pas epilogut të tillë deklaroi se nuk është i befasuar nga kjo ngjarje skandaloze.

Qyteti i Shkupit në tre vitet e fundit përpiloi studim fizibilitet për tramva-jin e Shkupit, zgjidhje projektuese, punonte në mënyrë aktive në gjetjen e mjeteve nga fondet evropiane, fitoi rejting kreditues i cili jep garanci për qëndrueshmëri financiare të projektit dhe në fund nga mjetet e qytetarëve të Qytetit të Shkupit në buxhetin për vitin 2009 siguroi 430 milion denarë për fillimin e realizimit të fazës së parë të projektit. Të gjitha përpjekjet e lartpërmendura ishin të mbështetura me vendime të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski, mori vendim për prishjen e tenderit për tramvaj.

**PENGESA TË VERDHA
NË BULEVARDE**

Ekipe të Qytetit të Shkupit filluan të vendosin pengesa të verdha për korsitë e autobusëve në të dy anët e bulevardit Partizanski odredi, në pjesën nga bulevardi Kliment Ohridski deri në rrugën 29 Nëntori. Barrierat e gomës së plasitkuar janë në gjatësi prej 120 milimetra dhe do të vendosen në lentat e verdha ekzistuese për automjete për transport publik të udhëtarëve në qytetin e Shkupit.

Qëllimi i barrierave të verdha është që të pengohet keqpërdorimi i lentave të verdha të destinuara për transport publik nga pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, si dhe për sigurimin e lëvizjes së pandërprerë të autobusëve që do të mundësojë shpejtësi më të madhe dhe kapacitet më të madh të lëvizjes të automjeteve për transport publik.

**SHËNDRITI SHESHI PARA SHATËRVANIT "LULJA E LOTOSIT"**

Kryetari i Qytetit Trifun Kostovski më 21 mars, Ditën e pranverës, në mënyrë solemne e lëshoi në përdorim sheshin e rikonstruktuar në hyrjen e Parkut të qytetit, tek shatërvani "Lulja e lotosit" dhe sheshin rreth përmendores së Goce Dellçevit. Manifestimi solemn në sheshin tek shatërvani filloi me performancën e Orkestrës së qytetit e më pas vazhdoi me përmbajtje të ndryshme kulturore, mes të cilave edhe performanca e SHKA "Orce Nikollov".

Sheshi në hyrjen e Parkut të qytetit u rikonstruktua në gjashtë muajt e kaluar. Në parterin janë vendosur pllaka të reja të travertit në sipërfaqe prej 3.000 metra katror. Është zëvendësuar mermeri edhe në bazamentin e shatër-

vanit "Lulja e lotosit" kurse shatërvani është pastruar tërësisht.

Njëzet e dy stolet e betonit janë ngjyrosur me ngjyrë të bardhë dhe janë vendosur ulëse të reja të drurit. Për personat me nevoja specifike janë bërë dy rampa më të vogla dhe një më e madhe për kalimin nga sheshi për në përmendoren e Goce Dellçevit.

Përmendorja e Goce Dellçevit është pastruar kurse mermeri i postamentit është ndërruar. Hapësira rreth pllakave është pasuruar me lloje të ndryshme të fidanishteve dhe është formuar rrugicë e re edhe prapa përmendores së Goce Dellçevit.

Për përtëritjen e pjesës hyrëse në Parkun e qytetit Qyteti i Shkupit nga buxheti ndau 17 milion denarë.

RINOVIM I DY BANJOVE NË SHTËPINË „11 TETORI“

Me donacionin e qytetit të vëllazëruar Nirberg në Shtëpinë për fëmijë pa prindër "11 Tetori" muajin e kaluar u rinovuan dy banjo. Donacioni është rezultat i bashkëpunimit shumëvjeçar dhe të frytshëm ndërmjet Nirbergut dhe Qytetit të Shkupit.

Jam veçanërisht krenar që qyteti i Shkupit tek qyteti i Nirbergut ka një mik të singertë i cili është i përgatitur të japë përkrahjen e tij edhe në momentet më të vështira. Dëshmi për

këtë janë edhe sanitaret e dhuruara nga Nirbergu në vlerë prej 15.000 euro. Qyteti i Shkupit obligohet edhe më tej të kujdeset për ju dhe t'ju sigurojë kushte sa më të mira në të cilat do të rriteni të rrethuar me dashuri dhe kujdesje – tha kryetari Trifun Kostovski duke dhënë në përdorim banjot e rinovuara.

Kryetari i Qytetit të Shkupit në emër të Qytetit të Shkupit fëmijëve u dhuroi edhe një sistem muzikor.



FILLOI RIKONSTRUKSIONI I KRYQËZIMEVE TEK “KOMBINATI I DUHANIT”

Katër kryqëzime dhe katër rrugë do të rikonstruktohen plotësisht dhe do të zgjerohen me projektin që javën e kaluar e filloi Qyteti i Shkupit. Bëhet fjalë për një projekt shumë të rëndësishëm dhe të ndërlikuar i cili, sipas parashikimeve, për 50% do të lehtësojë qarkullimin në këtë pjesë të qytetit. Korniza financiare e projektit për rikonstruksionin e rrugëve dhe kryqëzimeve

Punët ndërtimore të planifikuara me rikonstruksionin përfshijnë rikonstruksion të kryqëzimit ndërmjet rrugëve 11 Tetori, Prolet dhe bulevardit Makedonija (degë); rikonstruksion të kryqëzimit ndërmjet rrugëve Prolet, “3-ra Makedonska brigada” dhe Slave Georgiev; rikonstruksion i kryqëzimit

ndërmjet rrugëve 11 Tetori, Ivan Kozarov dhe bulevardit Makedonija (degë); rikonstruksion i kryqëzimit ndërmjet bulevardit të ndërtuar Makedonija dhe dy degëve të tij; rikonstruksion (zgjerim) në rrugën 3-ra Makedonska brigada në pjesën nga bulevardi Nikolla Karev deri te rruga Prolet; rikonstruksion (zgjerim) i rrugës prolet në pjesën nga „Kombinati i duhanit“ deri te rruga “3-ra Makedonska brigada”; rikonstruksion (zgjerim) i rrugës Ivan Kozarov me gjatësi rreth 100 metra; rikonstruksion (zgjerim) i rrugës Slave Georgiev me gjatësi prej rreth 50 m.

Punët ndërtimore do t'i kryejnë ekipet e „Mavrovoinzhenering“ në afat prej dhjetë ditë pune, në varësi të kushteve atmosferike.

DISPLEI NË STACIONET E AUTOBUSIT TË LINJËS 57

Vendosja e displejeve në stacionet e autobusit që do të informojnë për kohën e arritjes së autobusit që presin udhëtarët, zhvillimi i Qendrës për drejtimin dhe kontrollin e qarkullimit, transformimi i 12 autobusëve të NQP me punë me gaz natyror të dhe përgatitja e strategjisë për transport urban të qëndrueshëm janë katër projektet që në katër vitet e ardhshme do t'i punojë Qyteti i Shkupit, në bashkëpunim me NQP “Shkup” dhe Fakultetin teknik të Manastirit, të cilët janë pjesë e projektit të madh evropian “RENESANSA”.

“RENESANSA” është projekt për testimin e strategjive inovative për qarkullim të pastër urban në qytetet historike evropiane, në të cilët, përveç Shkupit janë përfshirë edhe Bat nga Anglia, Peruxha nga Italia, Gorna Orahovica nga Bullgaria dhe Shihinek nga Polonia.

Qyteti i Shkupit muajin e kaluar ishte nikoqir i takimit dy ditor të konzorciumit të përbërë prej 30 anëtarësh nga 5 vende evropiane që janë pjesë e projektit “RENESANSA”, në të cilin u diskutua për aktivitetet e deritanishme të cilat në suazat e projektit u realizuan në secilin prej këtyre pesë qyteteve. Në fund të takimit u përcaktuan edhe aktivitetet e ardhshme. Për herë të parë në vendin tonë qyteti merr mjete financiare nga Unioni Evropian nëpërmjet programit FP7 me vlerë prej 700.000 euro për kofinacimin e katër projekteve të përmendura.

- Deri në fund të vitit si pjesë e projektit “RENESANSA” në të paktën tetë stacione autobusi të linjës 57 në territorin e qendror të qytetit do të vendosim displej në të cilin qytetarët në kohë reale do të informohen për sa minuta do të arrijë në stacion autobusi që e presin. Ky hap do t'ju ndihmojë qytetarëve që më lehtë t'i planifikojnë kohën dhe obligimet. NQP “Shkup” së shpejti përmes tenderit do t'i furnizojë tabelat informative. Pjesë të mjeteve për realizimin e këtij aktiviteti i kemi. Sistemi të cilin tani e furnizojmë për Lokalizim automatik të automjeteve do të ndihmojë që përmes softuerit adekuat të merren të dhëna të sakta për lëvizjen e autobusit dhe për arritjen e tij në stacion – thotë Jovan Hrisotvski, drejtues i Sektorit për komunikacion të Qytetit të Shkupit.



U LËSHUA NË PËRDORIM PJESA E PARË E BULEVARDIT “MAKEDONSKA VOJSKA”

Kryetari i Qytetit të Shkupit Trifun Kostovski më 20 mars të këtij viti në mënyrë solemne e lëshoi në përdorim pjesën e parë të bulevardit “Makedonska vojska” në komunën Gjorçe Petrov. Në fazën e parë të realizimit të këtij projekti kapital qarkullimi, nga kryqëzimi me bulevardin “Partizanski odredi” deri te kryqëzimi me rrugën Gjorçe Petrov u ndërtuan dy korsi rrugore me gjatësi 400 metra dhe dy trotuare anës rrugës.

Në pjesën e përfunduar të bulevardit “Makedonska vojska” është vendosur ndriçim i ri publik dhe kanalizim atmos-

ferik dhe është përfunduar plotësisht rregullimi hortikulturor i sipërfaqes.

Edhe pse nuk ishte pjesë e projektit, me donacionin e Qytetit të Shkupit është përfunduar me shtrimin me pllaka të hapësirës parking tek kisha “Shën. Petar dhe Pavle” në komunën Gjorçe Petrov.

Mjetet financiare me vlerë prej 17 milion denarë u siguruan plotësisht nga Buxheti i Qytetit të Shkupit. Punët ndërtimore i realizuan ekipet e “Granit”.

BASHKËPUNIM I FRYTSHËM NDËRKOMBËTAR 2005 - 2009

Dyzet delegacione të larta të drejtuara nga kryetarë, zëvendës kryetarë, kryetarë këshillash dhe funksionarë të lartë vizituan Qytetin e Shkupit në katër vitet e kaluara.

Bashkëpunim më i ngushtë është realizuar me qytetet e vëllazëruara Tempi /SHBA, Nançhang/Kinë, Nirberg dhe Drezden/Gjermani, dhe veçanërisht imponon bashkëpunimi i vendosur me Varen/Belgjikë dhe Dizhon/Francë. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe Stambolli, me të cilin kemi lidhje të veçanta, si dhe me kryeqytetin e Rusisë, Moska.

Mysafirë të qytetit të Shkupit ishin përfaqësues nga Volagong/Australi, Stokholm/ Suedi, Podgoricë/Mali i Zi, Sarajevë/Bosnja dhe Hercegovina, Beograd, Sofija, Tirana, Lubjana, Bukuresht, Athinë, Shtutgard, Maribor, Idrija, Bari dhe Talin.

Në planin e bashkëpunimit bilateral Shkupi lidhi edhe dy vëllazërime me Lubjanën dhe Podgoricën dhe u nënshkrua marrëveshje për bashkëpunim me Sarajevën. Në takimet me përfaqë-

suesit e huaj dominues ishte këmbimi i përvojave për punë të administratave të qytetit, për financimin e vetëqeverisjeve lokale, asociacionet evropiane dhe shfrytëzimi i mjeteve nga fondet evropiane, këmbimi i përvojave nga fusha e decentralizimit etj.

Shkupi ishte nikoqir i Konferencës së 11-të të Unionit të kryeqyteteve të Evropës qendrore dhe juglindore. Përveç kësaj konference, nga manifestimet evropiane u mbajt konferenca TRANSPAUEP për koncepte qarkullimi urban, si dhe punëtori një ditëshë e UITP/unioni ndërkombëtar për transport publik/.

Qyteti i Shkupit përkrahu organizimin e manifestimit ndërkombëtar FORUM/Shkup "Soul for Europe". Ideja kryesore e manifestimit është të mbledhë në një vend politikanë, sektorin civil, përfaqësues të sferës ekonomike dhe kulturore në nivel rajonal, si dhe vende të tjera Evropiane, duke përfshirë edhe anëtarë të Parlamentit Evropian, me qëllim të

diskutojnë për rolin e kulturës dhe iniciativave qytetare për ndërtimin e strukturave demokratike dhe ngritjen e nivelit të ekonomisë dhe mbrojtjen sociale në Evropë.

Qyteti i Shkupit, ishte përkrahësi kryesor i iniciativës për mbajtjen e bienales evropiane për artistë të rinj, e cila falë përkrahjes do të mbahet në shtator të këtij viti dhe në të do të marrin pjesë 1.000 artistë të rinj nga Evropa.

Qyteti i Shkupit u bë anëtar shoqëruar i Eurocities, organizatë në të cilën janë anëtarë kryeqytet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ndërkohë që shumë pak qytete nga vendet e mbetura në Evropë kanë nderin të jenë anëtarë shoqëruar.

Me iniciativën e Kryetarit të Qytetit të Shkupit Trifun Kostovski. Këshilli i Qytetit të Shkupit nga fundi i vitit të kaluar solli Vendim Qyteti i Shkupit të hapë zyrë në Bruksel, sipas shembullit të metropoleve të tjera evropiane.

Qytete të vëllazëruara – Nançhang LIQENE NË QYTET DHE QYTET I LIQENEVE

Dy lumenjtë dhe tre liqenet në brigjet e të cilave shtrihet ky metropol me të drejtë i jep epitetin "qytet i ujit". Sipërfaqet e shumta ujore në një mënyrë të veçantë e mbush qytetin me energji jetësore. Malet në afërsi të tij dhe sipërfaqet e mëdha të gjelbëruara dhe kopshte në të përbëjnë ekosistemin e shkëlqyer natyror. Ju prezantojmë Nançhangun, kryeqytetin e provincës Xiangshhi në juglindje të Kinës, me një popullsi prej 4.9 milion banorë.

Nançangu bën pjesë ndërmjet 35 qyteteve më të mëdha të Kinës. Ai është një qendër e rëndësishme historike dhe kulturore e Kinës, me një histori të pasur që daton para 2200 vjetësh. Tradita e famshme revolucionare e qytetit e bën Nançhangun një "qytet-hero". Këtu janë formuar forcat e armatosura të Republikës Popullore të Kinës dhe për herë të parë është valëvitur flamuri i forcave të kuqe.

Sot, Nançangu përbën një qytet të hapur dhe dinamik që pulson në përputhje me rrjedhat e modernizimit në botë. Është vlerësuar si një nga vendet më të mira për jetesë në Kinë. Karakteristikë është industria e zhvilluar dhe ofron mundësi biznesi



të shkëlqyera.

Në Nanchang ka një numër të madh monumentesh historike por edhe moderne. Në sheshin Kiushui në Nanchang gjendet shatërvani më i madh në Kinë, ku lartësia e ujit arrin lartësi prej 128 metrash. Në afërsi të Nançangut është edhe liqeni më i madh natyror "Pojiang" në Kinë i njohur si "parajsë për zogjtë shtegtarë". Në qytet gjendet rolerkosteri "Ylli i Nançangut" me lartësi 160 metra, që është nga më të lartët në botë. Nga monumen-

tet kulturore-historike në Nançhang gjendet tempulli "Tengvang" i cili daton nga viti 653 dhe është një nga katër tempujt më të rëndësishëm në të gjithë Kinën.

Qyteti i Shkupit është vëllazëruar me Nanchangun në vitin 1985, por bashkëpunimi intensiv me nënshkrimin e Memorandumit për miqësi në vitin 2005. Në shenjë mirënjohje për miqësinë me Shkupin, një nga bulevardet më moderne në Nanchang mban emrin Shkup – Nanchang – Miqësi. T.S.

QYTETI I SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit
TRIFUN KOSTOVSKI
tel: 3 297 204
gradonacalnik@skopje.gov.mk
baraka nr: 4

Sekretari i Qytetit të Shkupit
LJUBISHA GEORGIEVSKI
tel: 3 297 281, 3 297215
baraka nr: 3

Kryetari i Këshillit të Qytetit të Shkupit
IRENA MISHEVA
tel: 3 297 207
irena.miseva@skopje.gov.mk
baraka nr. 1

Sektori për financa
Drejtues: Kërste Anadonovski
tel: 3 297 277
kandonovski@skopje.gov.mk
baraka nr: 7

Seksioni për përcaktimin dhe pagimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve tjera
tel: 3 297 280 - tatim dhe dhurata
tel: 3 297 316- pronë
tel: 3 297 314- taksa
danoci@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR MBROJTJEN E AMBI-
ENTIT JETËSOR DHE TË NATYRËS
Udhëheqës: Cvetanka Ikonomova -
Martinovka
tel: 3 297 301, baraka nr: 14
Cvetanka.Ikonomova@skopje.gov.
mk
infoekologija@skopje.gov.mk

•SEKTORI PËR PUNË KOMUNALE
Udhëheqës: v.d Jelena Perinska
tel: 3 297 392, baraka nr: 11
Jelena.Perinska@skopje.gov.mk

Inspektorati i Qytetit të Shkupit
Drejtues: Hamzi Xhaferi
tel: 3 297 359
hamzidz@skopje.gov.mk
baraka nr: 14

NDËRMARRJET PUBLIKE

NP "Parkingu i qytetit"
Drejtor: Ljupço Jovanov
jovanovlj@gradskiparkig.com.mk
tel: 3091 072 , 3091 074
www.gradskiparking.com.mk

Shërbimi i merimangës
tel: 3 238 871

NP "Rrugë dhe rrugica"
Drejtor: Ilija Martinovski
tel: 3 162 317

www.jpuliciipatista.com.mk
NQP "Shkup"
Drejtor: Alaksandar Boshkoviç
aboskovic@jsp.com.mk
tel: 3 174 265
www.jsp.com.mk

Qendra e dispeçerisë:
tel: 3 173 224

NP "Higjiena komunale"
Drejtor: Zlatko Dimovski
tel: 3 220 827
www.khigiena.com.mk

NP "Parqet dhe gjelbërimit"
Drejtor: Dushan Aviroviç
tel: 3 070 112

NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi"
Drejtor: Igor Arnaudov
tel: 3 220 839
www.vodovod-skopje.com.mk

Rajonet për pagesë dhe mirëm-
bajtje të rrjetit të ujësjellësit dhe
kanalizimit

Rajoni 1 – Qendër
pagesa tel: 3 117 753
reoncentar@vodovod-skopje.com.
mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 238 992
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 137 123

Rajoni 2 – Kisella Voda
pagesa tel: 3 116 987
reonkiselavoda@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 782 609
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 791 566

Rajoni 3 – Karposh
pagesa tel: 3 118 581
reonkarposh@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 076 407
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 062 174

Rajoni 4 – Çair
pagesa tel: 3 117 673
reoncair@vodovod-skopje.com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 2 671 888
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 2 671 999

Rajoni 5 – Gazi Babë
pagesa tel: 3 116 889
reongazibaba@vodovod-skopje.
com.mk
mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit
tel: 3 174 524
mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit
tel: 3 174 524

INSTITUCIONET KULTURORE TË
QYTETIT

- Biblioteka „Vëllezërit Milladinov“
3162-544
- Qendra informative kulturore
3115-238
- Shtëpia e kulturës „Koço Racin“
3163-739
- Qendra kulturore rinore 3115508
- Muzeumi i qytetit të Shkupit
3115-367; 3113-609
- Salla Univerzale-Shkup 3245615
- Kopshti zoologjik 3220-578
- Qendra kulturore e fëmijëve
„KARPOSH“ 3228 - 111

NUMRAT MË TË RËNDËSISHËM

- Shërbimi i zjarrfikësve 193
- Qendra për menaxhimin me krizat
195
- Elektro-Shkup 02 3161454
- Ngrohtorja 02 3076200
- Qendra urgjente 02 3147147
- Spitali i qytetit 02 3130311
- Aeroporti „Aleksandar Makedon-
ski“ 02 3148333; 02 3148336
- Stacioni ndërkombëtarë i auto-
busëve 02 2466011; 02 2466313
- Stacioni hekurudhor 02 3164255
- Shërbimi amë - DQPM 3117 037;
3117 766
- Salla e kurorëzimeve 3118 250
- Inspektorati republikan i tregut
975
- SOS – gjendjet e krizës për fëmijët
dhe të rinjtë 0800 12 222; 3136 400
- SOS – për gratë dhe fëmijët vik-
tima të dhunës 9700
- SOS – informata dhe parandalimi
i tregtisë me njerës 0800 11 111;
3173 424
- Teatri dramatik 3063388
- Qendra teatrale e fëmijëve
3290111
- Opera dhe baleti maqedonas -
OBM 3114511
- Galeria kombëtare e Maqedonisë-
Stacioni i vogël 3126856

KOMUNAT E SHKUPIT

- Komuna Qendër 3203 680
- Komuna Kisella Voda 2785 400
- Komuna Aerodrom 2400 970
- Komuna Karposh 3061 507
- Komuna Gazi Babë 3226 655
- Komuna Çair 2616 865
- Komuna Butel 2616 868
- Komuna Shuto Orizare 2650 584
- Komuna Gjorçe Petrov 2039 307
- Komuna Saraj 2050 289

